

*buletini*info

Buletin informativ mujor
Prill, 2022



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I PLOTË I STACIONIT TRANSFER NË LAGJEN ALI IBRA” NË GJAKOVË



Fridon Lala në “Ora 7”
në Klan Kosova



Dëshmitë shqiptare të
mitologjisë egjiptiane të
konvertuar në krishterim



Shteti për arsimin,
arsimi për shtetin

Qeveria e Kosovës përfshinë edhe prioritetet e IRDK-së

Nuk ka dyshim se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe komunitetet etnike jo shumicë, janë pjesë e shoqërisë së Kosovës, ku pretendohet që të gjithë të jetojnë me mundësi të barabarta. Kosova është projektuar si shoqëri multietnike, ku shumica dhe komunitetet jo shumicë janë pjesëmarrës në vendimarrje dhe të gjithë marrin pjesë në përfaqësimin e interesave të komuniteteve respektive. Pra roli i përfaqësuesve politik, në veçanti i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë përmbushet atëherë kur arrihet përfshirja e vizionit politik të komuniteteve në vizionin qeverisës. Atëherë çfarë po ndodh konkretisht në një vit qeverisës kur IRDK është pjesë e Qeverisë së Kosovës dhe përfaqëson komunitetin Egjiptian përmes pozitës së garantuar me kushtetutën e Kosovës? Arsimimi, Varfëria, Infrastruktura, Punësimi ishin shtyllat kryesore të programit politik të IRDK-së.

Arsimimi: Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të MAPL, të cilën e udhëheq ministri Elbert Krasniq, dhe MASHT, që udhëhiqet nga ministrja Arberije Nagavci. Qëllimi është që të rritet numri i mësimdhënësve nga radhët e komuniteti Egjiptian. Subvencionimi me bursa dhe përcjellja e të diplomuarve që të përfshihen në mësimdhënie është një plan konkret për të arritur qëllimin.

Varfëria: Janë dhënë 1 milion euro për kuzhina popullore ku më shumë se 70% e fondit të ndarë nga Qeveria menaxhohet dhe përfitojnë komuniteti Egjiptian, Ashkali. 34 mijë pako ushqimore, secila në vlerë prej 50 euro, pra gjithsej 1.4 milion euro shpërndahen për familjet skamnore ku mbi 70% e përfituesve do të jenë pjesëtarët në nevojë nga radhët e komuniteteve Egjiptian, Ashkal e Rom. Masat e ndërmarra nga Qeveria për dyfishim të asistencës sociale për muajin Prill, 100 euro për pensionist dhe student, rritja e pensionit bazë në vlerën jo më pak se 100 euro, subvencionimi i lehonave dhe shtesat për fëmijë janë masa që prekin shtresën e varfër të Kosovës dhe rrjedhimisht edhe të varfëritë e komuniteteve Egjiptian, Ashkali e Rom.

Infrastruktura: Gjatë vitit të kaluar MAPL targetoj komunitetet nëpër të gjitha komunat e Kosovës.

Kjo nuk ishte praktikë e Qeverive të kaluara. Në këtë mënyrë u realizuan projekte kapitale për komunitete si asnjëherë më parë. Në këtë muaj, MAPL, e udhëhequr nga ministri Elbert Krasniqi, hapi thirrjen për projekte me fokus komunitetet, me vlerë mbi 1 milion euro. Pritet që komunat anëmbanë Kosovës të aplikojnë dhe të përfitojnë në përmirësimin e infrastrukturës së komunitetit Egjiptian, Ashkali, Rom, Boshnjak, Turk etj. Është bërë ndarje buxhetore për projektin e ujit të pijes në Fushë Kosovë dhe projektin për largimin e deponisë së mbeturinave në lagjen Ali Ibra në Gjakovë.

Punësimi: Qeveria mbetet e përkushtuar për rritjen e numrit të policëve, kadetëve të FSK nga radhët e komunitetit Egjiptian, Ashkali e Rom. Për këtë arsye ofroj mundësi që të interesuarit për polic të përgatiten për test në Akademinë Policore në Vushtri. Edhe FSK do të gjejë mënyra që të lehtësohet përfshirja e komunitetit tonë në këtë institucion të Sigurisë. Zyra e Kryeministrit të Kosovës është duke e bërë vlerësimin e sektorëve ku mund të rekrutohen pjesëtarët e komuniteteve Egjiptian, Ashkali e Rom në Shërbimin Civil në mënyrë që të përmbushet kriteret ligjore për gjithëpërfshirje.

Këto masa të Qeverisë janë realizuar dhe në realizim e sipër. Shumica e masave, si: Kuzhinat popullore, pakot ushqimore, projektet infrastrukturës me fokus komunitetet, përgatitja kandidatëve për polic për testim, bursa për studentet me qëllim të rritjes së mësuesve nga radhët e komunitetit tonë, projektet për ujin e pijes në Fushë Kosovë dhe largimi i mbeturinave në lagjen Ali Ibra në Gjakovë, janë rezultat i vizionit politik i përfaqësuesve të IRDK-së, të cilat po zbatohen nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Këto rezultate konkrete nuk janë të mjaftueshme, sepse mbeten shumë probleme që rendojnë mbi supet e komuniteti Egjiptian. Mirëpo, përfshirja e prioritetëve të IRDK-së nga ana e Qeverisë së Kosovës, është njëkohësisht edhe fillim i përmbushjes së rolit të përfaqësuesve politik. Kjo nuk po bëhet me fuqinë politike të numrave por me mirëkuptim dhe ofrim të alternativave për problemet tona të shumta.

Fazli Stollaj



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I PLOTË I STACIONIT TRANSFER NË LAGJEN ALI IBRA” NË GJAKOVË

Me datën 15 Prill, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal sëbashku me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu dhe Kryetarin e Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin 'Rehabilitimi i plotë i Stacionit Transfer dhe pjesës para stacionit në lagjen Ali Ibra'.

Përmes këtij projekti do t'i jepet fund ajrit të ndotur dhe deponisë së mbeturinave e cila ka pamundësuar jetesën normale të qindra familjeve nga komunitetet.

Problemi i deponisë së mbeturinave në stacionin transfer në lagjen Ali Ibra është problem i kamotshëm që nuk është zgjidhur deri me tani. Në buxhetin e këtij viti, është bërë ndarje e veçantë buxhetore në vlerë prej 350 mijë euro dhe bartës i projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit. Procedurat e tenderimit dhe mbikçyrjen e realizimit të projektit do ta bëjë Ministria e Infrastrukturës.

Për problemin e mbeturinave në lagjen Ali Ibra, në mandatin e kaluar, në cilësinë e deputetit, kryetari i IRDK-së, Elbert Krasniqi ka qenë shumë i zëshëm. Qeveria e drejtuar nga Avdulla Hoti kishte ndarë 400 mijë euro për këtë projekt por problemi i mbeturinave mbeti i pa zgjidhur. Nuk kishte transparencë lidhur me shpenzimin e mjeteve të ndara.

Ministri Elbert Krasniqi dhe deputeti Fridon Lala kanë qenë të angazhuar shumë që projekti të buxhetohet për këtë vit. Përkushtimi i tyre, për këtë problem, është i vazhdueshëm në mënyrë që ky problem të zgjidhet dhe komuniteti Egjiptian që jeton në këtë lagje të jetoj në ambient që i plotëson kushtet normale për jetë. Realizimi i këtij projekti do të ju siguroj familjeve të lagjes Ali Ibra në Gjakovë një ambient më të pastër dhe më të sigurt.



34 MIJË PAKOVE NË VLERË PREJ 1.7 MILION EURO PËR FAMILJET NË NEVOJË

Me datën 29 Prill, Ministria e Financave dhe Trasfereve ka nënshkruar marrëveshjet me 39 organizata përfituese që do të shpërndajnë 34 mijë pakove në vlerë prej 1.7 milion euro për familjet në nevojë.

Ky vendim është marrë në kuadër të masës 3.4 për mbështetje të familjeve.

Pakoja ushqimore do të jetë deri në 50 euro për familje, derisa së paku 70% e vlerës së pakos do të jetë me produkte vendore.

Një numër i konsiderueshëm i organizatave përfituese për shpërndarje të pakove i takojnë komunitetit Egjiptian e Ashkali. Fokusi i këtyre organizatave do të jenë familjet e varfëra nga radhët e komunitetit Egjiptian, Ashkali. Kjo është hera e parë që me problemin e familjeve të varfëra merret Qeveria e Kosovës, ndërsa shpërndarja e pakove bëhet nga organizatat jo politike të cilat merren me çështje humanitare. Në këtë rast nuk do të kemi fotografi të zëvendës ministrave apo deputeteve të komuniteteve të cilët gjithmonë e kanë degraduar humanizmin e njerëzve vullnet mirë të cilët kishin vullnet të mirë për të ndihmuar.

Tani po demaskohen ish përfaqësuesit e komunitetit Egjiptian të cilët i keqpërdoren ndihmat e diasporës sonë duke i shndërruar pakot në kapital politik. Përdorimi i humanizmit për të përfituar politikisht është keqpërdorim dhe nuk ka aspak të bëjë me rolin e përfaqësuesit politik. Përkrahja e familjeve të varfëra nga Qeveria e Kosovës është mënyra e duhur se si përfaqësuesit aktual politik të komunitetit Egjiptian i adresojnë dhe bëjnë hapa konkret për problemet e komunitetit.

Qytetarët që kanë nevojë për mbështetje, të drejtohen te organizatat humanitare në komunën e tyre.



ASISTENCA SOCIALE DHE PËR PUNËT TJERA QË PO BËHEN PËR KOMUNITETIN

Me datën 26 Prill të këtij viti, deputeti i Parlamentit të Kosovës nga radhët e IRDK-së, i cili e përfaqëson komunitetin Egjiptian, ishte i ftuar në emisionin "Ora 7", në Klan Kosova. Po e sjellim intervistën e deputetit Fridon Lala për lexuesit e Buletin "Info".

Janë ndarë nga 100 euro nga Qeveria. Sa është e mjaftueshme kjo shumë dhe sa do ta lehtësoj jetën kjo shumë?

Komuniteti Egjiptian fatkeqësisht akoma vazhdon të jetë një prej grupeve me më nevojë në Kosovë për shkak se ende vazhdon të jetoj në margjinat e shoqërisë kosovare me një mesatare shumë të vogël të cilët janë të inkuadruar në tregun e punës, kështu që normalisht që këto ndihma, këto pako të ndihmës sociale, të cilat nuk vijnë për herë të parë por edhe në të kaluarën, gjatë vitit të kaluar i kemi pas disa ndihma në skemën sociale të Kosovës të cilat kanë shumë të mirëpritura. Me 100 euro nuk mund të bëhet ndonjë zgjidhje të madhe por për një familje të varfër e cila konsiderohet se jeton me rreth 60 cent në ditë ia lehtëson ekzistencën ditore të cilët ata luftojnë çdo ditë.

A po angazhoheni pak më shumë përtej kësaj shume, 100 euro, sepse tash muajt tjerë nuk do ta marrin këtë shumë?

Faktikisht për muajt nëntor dhe dhjetor, familjet sociale kanë marrë dyfishin e shumës që marrin për muaj. Tani me këtë skemë i marrin 100 euro familjet të cilat janë përfituese të kësaj skeme sociale por kemi pjesëtarë të komuniteteve në kategori tjera të cilat Qeveria ka vendosur ti subvencionoj, kemi studentë, që është shumë e mirëpritur, kemi edhe pensionistë nga radhët e komuniteteve. Jemi të pajtimt që me 100 euro nuk bëhet zgjidhja e problemeve të grumbulluara tash e 20 vite mirëpo sado pak ia lehtësojmë ekzistencën në baza ditore.



Përveç kësaj Qeveri i ka ndarë 1 milion euro për kuzhina popullore të cilat i ushqejnë familjet e varfëra. Në këto kuzhina 80% e përfituesve janë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në bazë të informatave kuzhinat i kanë 100-150 familje që i ushqen dy apo tri herë në ditë, varësisht prej kapaciteteve. Kuzhinat përfituese të komunitetit ndodhen në rajonin e Dukagjinit: Klinë, Pejë, Istog. Pastaj në Prizren, Ferizaj, Lipjan ku janë më shumë të shtrira komunitetet. Kuzhinat i bëjnë listat e familjeve të varfëra, nuk e di saktë procesin e identifikimit por janë një numër i madh i familjeve që përfitojnë. Përveç asaj Qeveria ka bërë një thirrje për organizatat që merren me ndihma të familjeve në nevojë, ku do të jenë diku 40 000 pako ushqimore dhe higjienike të cilat do të jenë shumë të mirëpritura nga pjesëtarët e komuniteteve për shkak se e dimë gjendjen e rëndë të tyre.

Në këtë mori të vendimeve kryesisht sociale të Qeverisë Kurti, a janë kategoria më përfituese komunitetet Egjiptian, Rom, Ashkali pasi që situata e tyre është bajagi e rëndë?

Po natyrisht kur kemi pako të kësaj natyre kategoritë sociale të cilat kanë më së shumti nevojë përfitojnë. Gjithashtu janë shumë të mirëpritura edhe pagesat të cilat bëhen për fëmijët dhe lehonat dhe ne si subjekt politik kemi asistuar te komuniteti për të plotësuar mbi 300 aplikacione të cilët kanë pasur probleme teknike me aplikimin. E dimë nga Ministria e Financave se mbi 3000 familje nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë të regjistruar në skemën sociale që do të thotë se këto familje janë prekur prej këtyre vendimeve. Po ashtu një hap tjetër tepër i madh për komunitetin ka qenë vendimi për rritje të pagës minimale, i cili ka qenë edhe premtim elektoral i ministrit të tanishëm Elbert Krasniqi, i cili e ka thënë publikisht në Kallxo.com. Nga rritja e pagës minimale komuniteti afektohet për shkak se raporte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, siç është organizata e punës tregojnë se komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përtej problemit që kanë që të punësohen në institucione publike, hasin në diskriminim edhe në sektorin privat. Përtej asaj që janë pak të punësuar bëhet diskriminim edhe në pagesa për shkak se pjesëtarët e këtyre komuniteteve paguhën më pak se një pjesëtar i komunitetit shumicë. Duhet të sqarohet sepse ka polemika për një pjesë të cilët nuk e kuptojnë konceptin e pagës minimale.

Pra me ligjin mbi pagën minimale definohet se një firmë nuk guxon të paguaj më pak se ajo shumë që përcaktohet, mirëpo nuk e ndalon që të paguaj më shumë në bazë të ofertës dhe tregut.

Si u përmend më herët është edhe vendimi për pagesë të 10 euro për fëmijët. Sa është numri nga radhët e komuniteteve që përfitojnë nga ky vendim?

Në bazë të shënimeve që disponojmë, dhe këto i kemi siguruar pasi që ka pas kërkesa që të asistojnë për aplikim në këto masa, ne si subjekt politik kemi asistuar mbi 300 raste për aplikim nëpër degë të ndryshme në gjithë Kosovën, qoftë për pagesa për lehona, qoftë për pagesa të shtesave të fëmijëve, në bazë të kategorive të cilat i ka ndarë Ministria e Financave.

Ndërkohë janë edhe 100 bursa për studentet. Si përfitohet ato dhe kush janë ata që mund të përfitojnë? Për çfarë lloj burse kemi të bëjmë?

Përtej asaj që ne jemi angazhuar në politikat sociale sepse ne përfaqësojmë një komunitet të varfër i cili jeton në Kosovë, duke e marrë parasysh vullnetin politik të kësaj Qeverie, kemi nisur edhe projekte kapitale të mëdha të cilat do të afektojnë në të mirën e mirëqenies së komunitetit. Njëra prej projekteve kapitale ka qenë që të ndahen bursa për studentët rom, ashkali dhe egjiptian, ku është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në mes të MAPL dhe Ministrisë së Arsimit. Ideja në këtë rast nuk është që vetëm të asistohen studentët për të përfunduar studimet mirëpo ideja është që këta student, sidomos studentët e Fakultetit të Edukimit të asistohen nga Ministria në mënyrë që pastaj të sistemohen si mësimdhënës në sistemin arsimor të Kosovës. Shuma ende nuk është e përcaktuar mirëpo ne gjatë fushatës dhe para fushatës, ne si subjekt politik gjithmonë e kemi ngrit si kauzë që numri i mësimdhënësve egjiptian është tejet i ulët. Pra pas tri viteve krijohen mundësi që këta përfitues të sistemohen si mësues. Nga 20 mijë mësues që janë të regjistruar në Kosovë, vetëm 5 figurojnë që janë nga radhët e komuniteti Egjiptian, e që është një shifër tejet shqetësuese. Pasta vetëm për këtë vit Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal që udhëhiqet nga ministri Egjiptian, Elbert Krasniqi, ka ndarë 1 milion euro për projekte infrastrukturore për lagje të komuniteteve anembanë Kosovës, do të thotë se është vazhdimësi e projekteve të vitit të kaluar ku janë ndarë rreth 2.5 milion euro për projekte kapitale. Ne e dimë që fatkeqësisht që 20 vite projektet janë ndaluar te lagjet e komuniteteve, pra kanë shkuar deri aty dhe nuk kanë pas vazhdimësi.

Megjithatë nga subjekti tjetër jo parlamentar PLE ka kritika të vazhdueshme ndaj mënyrave se si po e menaxhoni, ju si subjekt që jeni në pushtet, situatën me komunitetet. Cila është përgjigja e juaj? Sa vërtetë po bëni? Sa vërtetë kanë bërë të tjerët para jush?

Roli i opozitës është me kritiku dhe me pa gjithçka zi mirëpo po besoj se për qytetarët është gjithçka e thjeshtë që t'i dallojnë dhe t'i masin sukseset për shkak se subjekti i cili në këto kushte po kritikon e që është në opozitë, ka qenë pjesë e qeverisjeve të kaluara, për rreth tetë vite, mirëpo nuk mundemi ta numërojmë asnjë projekt kapital. Nuk po flasim për politika ditore popullsitë, reagime. Nëse kemi një rast të diskriminimit duhet të reagoj secili qytetar i Kosovës. Mund të reagoj secili aktivist i të drejtave të njeriut. Nuk është rol i deputetit, ministrit apo përfaqësuesit politik vetëm të reagojnë dhe të presin vetëm fatkeqësi. Fatkeqësisht përfaqësuesit e kaluar nga radhët e komuniteteve kanë pritur vetëm fatkeqësi në radhët e komunitetit në mënyrë që ata të marrin një vëmendje mediale dhe të dalin e ta mbrojnë komunitetin. Këto raste ndodhin dhe reagon krejt shoqëria. Përfaqësuesit politik janë aty që te kenë vizion qysh zhvillohet jo vetëm për një mandat por për 10 – 15 vite për shkak se kemi marrë besimin qytetar dhe ai besim është i shenjtë. Po i përmendi edhe dy projekte që janë pjesë e ndarjeve buxhetore të vitit të kaluar. Është viti 2022 edhe lagjet e komunitetit ashkali, rom e egjiptian në Fushë Kosovë akoma nuk kanë ujë të pijes. Po flasim për një lokacion i cili është disa kilometra larg kryeqytetit të Kosovës.



Edhe partia që ka qenë në pushtet nga radhët e komunitetit Egjiptian, që tash gjuan gur në qeverisjen aktuale mirëpo edhe përfaqësuesit të tjerë që 22 vite kanë dështuar që të sigurojnë sendin elementar, po flasim për ujin e pijes. Kjo po bëhet brenda një viti të qeverisjes tonë. Vitin e kaluar, me kërkesën tonë, në Ministrinë e Infrastrukturës janë ndarë 350 mijë euro të shtrihet rrjeti i ujësjellësit edhe në lagjet e komunitetit. Po ashtu është bërë ndarje buxhetore për largimin e mbeturinave nga Lagja Ali Ibra në Gjakovë. Po flasim për mbeturina të cilat e mbrrinë shifrën diku 600 mijë ton të grumbulluara në lagje ku jetojnë mbi 200 familje nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ka pas ndarje edhe në të kaluarën mirëpo e dimë se si ka shkuar dhe problemi akoma ekziston. Kështu që brenda një vit qeverisje, me të gjitha këto projekte kapitale kemi bërë jo vetëm atë që se kanë bërë ata me vite por për më shumë se 20 vite nga komunitetet.

Megjithatë ka shumë shtëpi të dëmtuara, ka shumë që nuk janë të punësuar. Çka mund të bëhet me ata?

Sfida që na kanë mbetur, përtej investimeve kapitale dhe programeve në edukim dhe fushat relevante është punësimi i komunitetit dhe çështja e banimit. Te punësimi kemi hapa konkret, ku ministri Krasniqi së bashku me ministrin e mbrojtës Armend Mehaj dhe ministrin e punëve të brendshme Xhelal Sveçla janë duke shikuar metodat dhe planet konkrete se si të rritet numri i pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian në Forca e Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

Sa persona mund të behën pjesë e këtyre institucioneve?

Po faktikisht konkurset kanë qenë të hapura për të gjithë. Për herë të parë kemi pas vullnet politik që Ministria e Punëve të Brendshme e ka hapur një akademi që i ka përgatit pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për testin që i nënshtrohen për t'u bërë pjesë e policisë së Kosovës por fatkeqësisht një pjesë shumë e madhe nuk kanë arritur prapë që ta kalojnë. Tash po shohin se si të përdorim metoda tjera se si t'i inkuadrojmë më shumë pjesëtar të komuniteteve në policinë e Kosovës dhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë jemi duke punuar në një dokumentacion të brendshëm apo një strategji e cila e rregullon punësimin në institucione publike. Kemi një Ligj për shërbyesit civil i cili akoma nuk implementohet. Ka vullnet politik dhe dokumenti momentalisht gjendet në zyrën e kryeministrit. Ligji e rregullon përqindjen e komuniteteve si shërbyes civil por problemi qëndron se Kosova e ka të ngarkuar administratën publike. Ligji nuk është zbatuar deri më tani. Nga mbi 14 mijë shërbyes civil vetëm 13 figurojnë se janë pjesëtar të komunitetit Egjiptian. Dokumentacioni që është duke u përgatitur përfshin një mapping në institucionet publike të cilat do të kenë mundësi punësimi dhe aty do t'i jepet përparësi komuniteteve që janë të nën përfaqësuar, mirëpo edhe në institucione direkt për shembull në Kuvendin e Kosovës, jemi duke i shikuar mundësitë deri ka fundi i vitit, po shpresojmë së bashku, ta hapim një thirrje e cila do të targetoj kryesisht komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe jam shumë shpresues që deri në fund të vitit do të kemi 3 apo 4 pjesëtarë të këtyre komuniteteve të punësuar në Kuvendin e Kosovës.

SHTETI PËR ARSIMIN, ARSIMI PËR SHTETIN



Jeton Rrahmani

Leximi, respektivisht arsimi fillimisht është normë hyjnore progresive për individin dhe shoqërinë. Fjala lexo erdhi si urdhër i prerë me të cilën filloi shpallja hyjnore në shekullin e VII të erës sonë. Arsimi duhet të jetë së pari çështje subjektive, çdo pyetje që e shtrojmë rreth kësaj teme duhet të shtrohet në vetën e parë. Se a jemi duke ecur para apo po kthemi mbrapa, matës për këtë është arsimi. Arsimi është shkaku kyç i civilizimit, andaj si komunitete jo shumicë në Kosovë jemi duke bërë përparim të dukshëm në këtë drejtim. Komunitetet tona gjithnjë janë paraqitur si grupacion me shkallë të ulët të arsimit, në shumë raporte të ndryshme, që nga periudha e pas luftës. Në pjesën e hershme të kësaj periudhe, këto të dhëna edhe mund të kenë qenë të sakta. Por sot sa herë që flitet për mos arsimimin, si fenomen apo në gjeneral, për arsimin në fjalën e parë, duhet të

përmenden kuadrot e shumtë që po dalin në pah dita e ditës krahas kushteve jo të volitshme ekonomike. Nuk mjafton vetëm të përmendën, ata duhen të përkrahen nga të gjithë e posaçërisht nga shteti. Kjo mund të llogaritet një hua e dobishme e shtetit ndaj studentëve ngase ky kontribut i shtetit ndaj studentëve do të kthehet në kontribut të studentëve në shtet kur në të ardhmen e afërt do të marrin tituj shkencorë. Andaj shteti për arsimin arsimi për shtetin. Por pse gjithë ky vrull që ne të konsiderohemi si jo të arsimuar? Për ne, mos arsimimi në fakt është pasojë ngase shkaku kryesorë është diskriminimi që e ka zanafillën qysh në bankat shkollore për nxënësit e këtyre komuniteteve. Nuk mund të gjesht askund sot një pjesëtarë të komunitetit që së paku një herë si nxënës me apo pa qëllim nuk është diskriminuar apo bullizuar në shkollë për prejardhjen e tij etnike. Ky diskriminim klasik racor jo çdo herë ka qenë i njëjtë andaj edhe ka ndikuar ndryshe tek nxënësit e komuniteteve, prandaj sot kemi individ të cilët janë dorëzuar përballë diskriminimit dhe kanë ndërprerë shkollimin e që është ndikuar edhe nga faktorë të ndryshëm siç është gjendja ekonomike familjare. Një mik i imi i respektuar më ka rrëfyer që si nxënës në shkollë fillore arsimtari i historisë kur e kishte nxjerrë tek dërrasa e zezë për ta pyetur për mësimet i kishte thënë: “Lëri mësimet por këndo një këngë se juve ju shkon zëri mirë”! Në anën tjetër kemi individ që e kanë luftuar diskriminimin siç është rasti i mikut tim që nuk ka pranuar të këndoje por të pyetet për mësimet. E pikërisht kjo i ka bërë më të fortë moralisht dhe më të suksesshëm në mësimet. Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë shumë më sy qelë karshi diskriminimit racorë dhe kjo ka bërë që diskriminimi të bije dukshëm si dukuri ndonëse ende mbetet prezent.

Por çfarë është ajo që ka bërë shteti për arsimin e në veçanti për arsimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian? Çfarë politika janë zhvilluar nga ana e shtetit në të kaluarën për rritjen e numrit të arsimuarve të këtyre komuniteteve? Sa është punuar për rritjen e numrit të mësimdhënësve nga radhët e këtyre tri komuniteteve? Në fakt çfarë po më kujtohet momentalisht është që nxënësit/studentët tonë kanë përfituar të holla lëmoshë nga xhepi personal i krerëve politik të komuniteteve. E kjo normalisht që është bërë me plan që këta studentë e intelektual të ardhshëm të shndërrohen në militant partiak, në vend se të krijohen dhe shtyhen përpara politika që do të ndikonin në mirëqenien e këtyre studentëve. E kaluara është e kaluar, ajo shkoi e bashkë me ta edhe këta politikan profiter. Tash natyrshëm lind pyetja se çfarë po bënë shteti sot? Shteti po mbështet financiarisht studentët e komuniteteve që studiojnë edukimin, për të vetmen arsye që të ketë sa më shumë mësues nga radhët e këtyre komuniteteve në shkollat e Kosovës. Ngase kur mësuesi vjen nga radhët e komuniteteve nuk do të kemi më nxënës nga komunitetet që do të ulen në bankat e fundit të

klasës, nuk do të kemi diskriminim e bullizim për përkatësinë etnike. Ngritja akademike e individit në fakt është ngritje për shoqërinë, shoqëria e ngritur është një shoqëri pa paragjykime. Paragjykimet zakonisht rrjedhin nga injoranca për njëri tjetrin derisa bëhen bindje. Bindja është ajo që qon në gjuhë të urrejtjes, prandaj arsimi për shoqëri të kulturuar. Organizata shoqërore e quajtur shtet po përdorë politika të duhura që kanë ndikim substancial për përparim të studentëve dhe vetë shtetit, e kjo nënkupton shteti për arsimin, arsimi për shtetin.



**Moikom Zego
(1949-2020)**

Dëshmitë shqiptare të mitologjisë egjiptiane të konvertuar në krishterim: Shenjtori me kokë qeni!

Në Bazilikën e Shën Nikollës në Voskopojë është pikturuar në vitin 1726, nga një gjeni i ikonografisë shqiptare, David Selenica, një numër i madh afreskesh me një forcë arti të jashtëzakonshme. Në një farë mënyre, Bazilika e Shën Nikollës mund të quhet një Kapelë Sikstinë e shqiptarit David, për një analogji dhe përafërsi që evokon kryeveprën pikturike të Mikelanxhelos.

Bazilika e Shën Nikollës ka filluar të ndërtohet në vitin 1721, në muajin qershor. Në 19 shtator të vitit 1722 kjo Bazilikë u përfundua. Pastaj ka filluar pikturimi afreskor.

Kunga u pikturua në mënyrë shembullore, si dhe madhështore, duke përfshirë edhe Naosin nga dora e të shumëditurit dhe nga furça e hollë e gjithë oshënarit, David Selenicasit, i ndihmuar edhe nga Konstandini dhe Kristo, që të dy piktorë.

Ktitor i bazilikës (d.m.th. ai që ka dhënë paratë dhe të gjitha shpenzimet), ka qenë tregtari i pasur i Voskopojës, Haxhi Jorgji.

Procesi i pikturimit ka, zgjatur katër vjet.

David Selenica është mbas Onufrit të shekullit XVI piktori më i madh i Ballkanit në artin kishtar në fillimin e shekullit XVIII dhe është bashkëkohës me një tjetër ikonograf shqiptar i jashtëzakonshëm, të quajtur Konstandin Shpataraku.

David Selenica është me origjinë nga fshati Selenica i Vlorës. Ky artist i madh ka pikturuar Kapelen Kukuzelika në Athos të Greqisë. Në mbishkrimin e lënë aty e quan veten me origjinë “nga Vlora”.



Ciklet pikturike të realizuara nga Davidi në këtë bazilikë janë sipas programeve ikonografike të njohura. Asnjëherë më parë afresku shqiptar nuk ka arritur një përsosmëri dhe madhështi të tillë.

Skenat e pikturuara nga Davidi janë me një logjikë të brendshme simetrike dhe të konceptuara me një madhështi njerëzore. Aty janë temat e Testamentit të Ri dhe motivet simbolike të Librit të Apokalipsit.

Davidi shkëlqen në portretizimin e shenjtorëve luftarakë, të shenjtorëve kalorës, si fjala vjen Shën Gjergji, Shën Teodor Stratilati, Shën Dhimitri etj.

Ky piktor i madh njihet ende pak. Nga pikëpamja artistike ai mund të quhet Kënga e Fundit e Mjellmës e artit kishtar në Shqipëri, por edhe në Ballkan.

Ajo që të tërheq vëmendjen në mënyrë të çuditshme në afreskat e Davidit është piktura e një shenjtori me kokë qeni. Ky shenjtor është pikturuar në këmbë, është i veshur me një veshje kishtarë të bardhë, me dorën e majtë të vendosur në gjoks, kokën e ka në profil të drejtuar nga ana e djathtë, është një kokë tipike dhe e zgjatur qeni.

Spikat syri njerëzor dhe veshi njerëzor, si dhe flokët e gjatë që i bien mbi shpatulla.

Koka është futur në një aulolë të portokalltë.

Një shenjtor me kokë qeni?

Ç'është ky shenjtor me trup dhe gjymtyrë njeriu por me koke prej qeni? Mos kemi të bëjmë me traditën pagane të centaurëve, gjysmë kuaj dhe gjysmë njerëz? Apo me hibridet e sirenave dhe të grifonëve? Si mundet që estetika e teologjisë së krishterë të pranojë një rafigurim të një shenjtori me kokë qeni? Ç'lidhje ka koka e qenit me krishterimin? Ç'përfaqëson ky shenjtor përbindësh?

Pyetjet janë bëfasuese dhe duket sikur nuk mund të kenë përgjigje mbushamendëse.

Në të vërtetë, motivi i shenjtorit me kokë qeni nuk buron nga tekstet biblike, por buron nga tekstet gnostike dhe apokrifë, që janë skualifikuar nga kisha.

Duke e studiuar këtë subjekt, si dhe mbishkrimin e shkurtuar pranë afreskut të shenjtorit me kokë qeni, mund të identifikojmë faktin se ky shenjtor quhet Shën Kristofori.

Shën Kristofori, sipas legendave dhe gojëdhënave apokrifë, ka qenë një njeri me shtat të madh, gjigand, i cili kinse e ka mbajtur Krishtin fëmijë për ta kapërcyer nga njeri breg i lumit në bregun tjetër. Prandaj, u mbiquajt Kristofor, emër i përbërë nga dy fjala, Krist, Krisht dhe For që do të thotë mbajtës. Emri i përbërë Kristofor do të thotë Krishtmbajtës.

Kulti i Kristoforit ka lindur në shekujt V dhe VI dhe mbijeton deri në shekullin XVIII në pikturën e David Selenicës. Ka patur dhe kisha kushtuar Shën Kristoforit në Shqipëri, por afresku i Shën Kristoforit me kokë qeni është diçka e pazakontë dhe një portret i vetëm në llojin e vet në krejt Shqipërinë.

Ç'përfaqëson koka e qenit?

Mitologët, që janë marrë me subjektet hibride të mitologjisë shpjegojnë se koka e qenit lidhet me një perëndi egjiptiane të lartë, të quajtur Anibus, ose Anubis. Kjo perëndi egjiptiane që e Vdekjes; përfytyrojeni në formën e një qeni, ose një çakalli, ose në trajtën e një njeriu me kokë Çakalli dhe qeni. Kjo Perëndi egjiptiane që Biri i Kryeperëndisë egjiptiane – Osirisit.

Në periudhën e dinastive të para të Egjiptit, ai adhurohej si hyjni që kujdesej për varrimin dhe balsamimin. Më vonë, në periudhën helenistike, ai bënte pjesë në kultin e Serapisit dhe të Isidës dhe u identifikua me Hermesin, Përcjellësin e Shpirtrave të të Vdekurve në Had.

Në shekujt e parë të Krishterimit, figura e Anibisit, ose Anubisit, u përvetësua nga ikonografia e hershme e krishterë, në funksionin e përcjellësit të të vdekurve në botën e përtejme. Kështu, një perëndi egjiptiane u përvetësua duke u krishtëruar.

Kaq e vërtetë është kjo sa që në një kishë, të tipit bazilikë të shekullit VI, të zbuluar në Antigonea pranë Gjirokastrës, është zbuluar një mozaik që paraqet figurën e një burri me veshje etnografike shqiptare, me opinga, e që ka një kokë qeni.

Mozaiku i Antigonesë ruan kështu dëshminë më të vjetër të Shën Kristoforit të konvertuar që nga kulti egjiptian i perëndisë së Vdekjes. Shën Kristofori me kokë qeni i Antigonesë ka përpara tij figurën e një gjarpëri dhe nga pas figurën e pemës së jetës të skematizuar. Në gjoks ka tri sumbulla, që përfaqësojnë Trinitet.

Qyteti i lashtë i Antigonesë është ndërtuar nga Pirro i Madh i Epirit në shekullin IV p.e.s., për nder të gruas të tij të vdekur Antigonea. Antigonea që vajza ilegale e mbretit Ptolemeu të Egjiptit, ku Pirroja në rininë e vet kishte jetuar në oborrin e tij për disa vjet. Ishte thjesht e Beronikës, gruas së Ptolemeut, Mbretëreshë e Egjiptit.

Është e kuptueshme që kulti i Perëndisë egjiptiane të vdekjes do të mbartej edhe në qytetin Antigonea. Ky kult ka mbijetuar për 10 shekuj, për t'u paraqitur i krishtëruar mozaikun e Antigonesë në formën e Shën Kristoforit.

Kjo quhet një mitologji e sinkretizuar, ose simbiozë e mitologjisë egjiptiane dhe asaj të krishterë. Është e habitshme se si figura e Shën Kristoforit me kokë qeni u pikturua nga David Selenicasi në shekullin XVIII.

Pra, në Shqipëri kemi dy Shën Kristoforë, atë të Antigonesë dhe atë të Voskopojës. Ky është një motiv jashtëzakonisht interesant për studiuesit e dyfishtë të mitologjisë dhe të ikonografisë.

Të dyja rastet lidhen me evoluimin e figurës së Shën Kristoforit brenda për brenda shtratit të Krishterimit Lindor.

Në pikturat dhe ikonografinë e Kishës Perëndimore Evropiane, Shën Kristofori nuk paraqitet me kokë qeni, por me fytyrë njeriu dhe trup vigan. Prandaj, Erzami i Roterdamit e quan Shën Kristoforin "Polifemi i krishterë".

Kështu, Shqipëria në veprat e saj të artit ruan diçka tepër të lashtë dhe origjinale, një dimension të mitologjisë egjiptiane të konvertuar çuditërisht në krishtërim.

Shën Kristofori i David Selenicës është kështu një dëshmi e mitologjisë së përzier, e paganizmit dhe e krishterimit.

Për fat të keq ky fakt nuk është bërë i njohur për studiuesit shqiptarë dhe të huaj.

Ky është kumtimi i parë i bërë nga ne për këtë subjekt tronditës.

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: buletini.info@gmail.com